

# UNIVERSITETI I PRISHTINËS

## ABSTRAKT

**Programi i studimit : Fakulteti Juridik "PROGRAMI JURIDIKO -FINANCIARË"**

**Kandidatja : ERANDA MAHMUTI**

**Mentor : AGIM PACA**

**Tema : "RRISKU KREDITOR I KAMATES "**

Dorëshkrimi synon që në mënyrë të përgjithshme të përshkruajë Riskun Kreditor të Kamatës. Trajtohet historiku i Paraqitjes dhe Zhvillimit të Bankave, Mekanizmi bankar, Institucionet Financiare Depozitare si dhe Procesi i Menaxhimit të Riskut në tërësi. Në vazhdim shtrohet çështja e Kontrollit dhe Monitorimit të Riskut.

Studimi vë në pah së pari parënë si mall specifik dhe funksionet e saj, duke vazhduar më tutje me bashkësinë e Institucioneve Financiare Depozitare si ndërmjetësues financiar; Bankat Komerciale, Asociacionet e Kursimeve dhe të Kreditit, Bankat e Kursimeve si dhe Unionet Kredituese. Kurse, kur flitet për Riskun dhe Menaxhimin e tij, në studim shpjegohen llojet e Riskut si dhe faktorët që sjellin deri tek ai. Kandidatja poashtu thekson rëndësinë e transparencës së Menaxhimit të Riskut duke njohur kështu figurën e tërësishme të Riskut, duke shfrytëzuar më pas mjetet dhe modelet e tij për përkrahje të procesit të vendimmarrjes, që është në fakt përcaktues i mbarëvajtjes së tërë procesit të Menaxhimit të Riskut. Analizimi i Menaxhimit të Riskut ndërkaq, përshkruhet në disa hapa që përfshijnë së pari Përcaktimin e Objektivave deri tek Zgjedhja dhe Zbatimi i Teknikave që ndihmojnë procesin e Analizimit të Riskut. Si element i rëndësishëm në Menaxhimin e Riskut poashtu paraqitet Vendorsja e Limiteve, Administrimi i Kredisë dhe Matja e Riskut të Kredisë.

Monitorimi dhe Kontrolli i Riskut si çështje me rëndësi ngërthen në vete trajtimin e faktorëve të jashtëm; faktorët ekonomik, faktorët politiko-ligjor, faktorët social-kulturor, faktorët teknologjik, faktorët ndërkombëtar; duke kaluar më tutje tek faktorët e brendshëm; që lindin nga aktiviteti i brendshëm i firmës, të cilët poashtu përbëjnë indikatorë të mëdhenj në këtë proces.

Si çështje në vete trajtohet edhe Komiteti i Bazelit, i cili është përgjegjës për identifikimin dhe monitorimin e bankave për procesin e transparencës. Studimi thekson se ky Komitet poashtu vendos rregulla se sa duhet të jetë kapitali i institucioneve financiare në mënyrë që të arritet të mbulohen humbjet

potenciale. Në studim gjithashtu potencohet se ky Komitet, ndër të tjera, mban përgjegjësi për mbajtjen e marrëdhënieve me Bankën Qendrore të Kosovës, si dhe autorite të tjera në kuadër të efektivitetit të kredisë.

Punimi arrin në konkluzionin se kredia si bërthamë e aktivitetit bankar, është shërbimi më tradicional që bankat ofrojnë për klientët e tyre dhe se rrisqet e kredisë me të cilat bankat përballen mund të përmblihen në katër kategori; rrishti i vendit, rrishti i industrisë, rrishti i kompanisë dhe rrishti i garancisë dhe dokumentacionit të kredisë. Gjithashtu, arrihet në përfundimin se Menaxhimi i Riskut është funksion i rëndësishëm dhe jetik për bankat dhe bizneset, si dhe çdo ndërmarrje, pa marrë parasysh madhësinë dhe veprimtarinë që kryen, në vazhdimësi përpiqet që Menaxhimi i Riskut të jetë pjesë thelbësore e operacioneve të tyre ditore.

Në bazë të vlerësimit dhe analizës së punimit të Diplomës për Master të kandidatës Eranda Mahmuti, Komisioni dakordohet në mendimin se konceptet teorike nga kjo lëmi janë hulumtuar dhe shtjelluar nga një këndvështrim mjaftueshëm i gjerë për një punim si ky.

Anëtarët e Komisionit kështu vlerësojnë se struktura dhe përmbajtja e hulumtimit shkencor si tërësi është punë e pavarur shkencore e kandidatës dhe mund të mbrohet.